**VENDIM**
**Nr.273, datë 6.4.2011**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA LINDORE", SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të rrugës "Unaza lindore", Shkodër.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen truall 24875.6 (njëzet e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtë) $m^2$, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 243 642 950 (dyqind e dyzet e tre milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë nëntëqind e pesëdhjetë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 1 561 000 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 243 642 950 (dyqind e dyzet e tre milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 15.4.2011 dhe të përfundojë më 15.7.2011.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja Shkodër", do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojë procedura e regjistrimit dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

10. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja, kufizim pronësie", do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të hiqet urdhri i kufizimit dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër, të ketë konfirmuar titullin e pronësisë.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja, Shkodër", pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", pasi pronarët të kenë përfunduar procedurat e regjistrimit, si dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja Shkodër, kufizim pronësie", sipas pikës 10 të këtij vendimi, pasi zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Shkodër të ketë konfirmuar

përfundimisht titullin e pronësisë, si dhe pasi pronarët të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

14. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

15. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

16. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**